



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 884/3 Prot.

Tiranë, më 17/7/2017

REKOMANDIM

Nr. 28, datë 17/7/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Banka e Kreditit të Shqipërisë" Tiranë:

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 150, datë 05.06.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Banka e Kreditit të Shqipërisë" me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

Kontrolluesi "Banka e Kreditit të Shqipërisë" përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës" (punonjës), manualisht dhe në format elektronik në rrjetin e brendshëm kompjuterik, për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave cctv, adresa të dhëna për shëndetin, dëshmi penaliteti, fotografi, etj.

1. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi "Banka e Kreditit të Shqipërisë" e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar por u konstatuan mangësi në përditësimin e njoftimit në lidhje me: "Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen" (nuk reflektohet përpunimi i të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës"), "Kategoritë e të dhënave sensitive që përpunohen" (nuk reflektohet përpunimi i të dhënave për gjendjen penale dhe të dhënave për shëndetin).

Detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

2. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, ka instaluar një sistem kamerash CCTV në degët ku ushtron veprimtarinë si dhe në ambientet e brendshme të zyrave qendrore. Nëpërmjet sistemit të video-survejjimit kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave punonjës dhe klientë.

Kontrolluesi nuk ka realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejjimit në hyrje të ambienteve (zyrave qendrore), ku ushtron veprimtarinë e tij në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit, në rubrikën "Politikat e privatësisë", rezulton të jenë publikuar një informacion i shkurtër lidhur me "Politikat e privatësisë" të kontrolluesit, por në këtë rubrikë nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Opinionin e Komisionerit "Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat", publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit në rubrikën Legjislacion/Opinione.

Në këtë kuadër vlerësojmë se nuk është respektuar neni 18 i ligjit pasi subjektet e të dhënave nuk informohen mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre. Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit të sanksionuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 30.06.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar prova në kuadër të masave të marra në zbatim të ligjit dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- ✓ Janë vendosur tabelat informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejjimit në hyrje të ambienteve (zyrave qendrore), në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;
- ✓ Në zbatim të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, është përditësuar formulari i njoftimit në përputhje me konstatimet e grupit të hetimit administrativ;

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 pika 1/"a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Banka e Kreditit të Shqipërisë" në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale.

mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;

2. Kontrolluesi "Banka e Kreditit të Shqipërisë" në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njohimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17 / 7 /2017

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI